REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1095/20
Datë/Datum. 28.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**18.12.2020**	**28.12.2020**	**Nr.1095/20,**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.12.2020, OE "**D&T Group**" ka parashtruar ankesë me nr.1095/20, kundër njoftimit për **dhënie** të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit"** me nr. prok. 622-20-4895-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Komuna e Prizrenit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **100.000,00 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, Nr. 794-796/20,
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "D&T Group"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
- Neni 1 i LPP-së- Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia ne trajtim/jo diskriminimi
- Neni 51 i LPP-së – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 i LPP-së – Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 i LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
Kompania jone e bëjmë këtë Ankese drejtuar Organit Shqyrtues te Prokurimit sepse kemi konstatuar se AK Komuna e Prizrenit ka bere lëshim gjate vlerësimit te ofertave sipas kërkesës ne dosjen e tenderit pikërisht tek FDT pika 9.1 & 9.2 ku kërkohet, citoj: Dëshmia 1. Lista e projekteve te natyrës se kontratës e vërtetuar per tri vitet e fundit nga OE-(e skanuar nga origjinali) per dosjen elektronike, te dëshmuara me referenca te cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo procesverbal te pranimit përfundimtar te furnizimeve. Pika 1 e kësaj ankese është se AK Komuna e Prizrenit edhe pas kthimit te lendes ne Rivlerësim nuk ka bere vlerësim te saktë te ofertës sipas kërkesave te dosjes se tenderit AK gjate vlerësimit te tenderit, ka here lëshim

te madh duke e rekomanduar per kontrate kompaninë PROFITECH sh.p.k e cila nuk i plotëson as kërkesat minimale te kërkuara ne dosjen e tenderit sipas kërkesave te FDT, pasi qe në te kaluarën kompania PROFITECH sh,p.k nuk ka bere asnjë furnizim me autoambulanca sipas kërkesës se dosjes së tenderit te FDT,::sepse kërkesa e AK Komuna e Prizrenit ne dosjen e tenderit konkretisht te FDT pika 9.1 & 9.2 është shume e qarte-ku thuhet: OE duhet te këtë se paku 150.000,00 euro kontrata te realizuara, te natyrës së kontratës, e natyra e kontratës është konkretisht Furnizimi me Ambulanca dëshmia e kërkuar dokumentare referenca ose proceset e pranimeve te furnizimeve, kompania ne fjaie nuk ka here asnjë furnizim te natyrës se kontratës Furnizimin me Ambulanca) gjate 3 viteve te fundit, por ka bere furnizime te makinerive te tjera qe nuk është e natyrës se kontratës dhe sipas kërkesës e cila është kërkuar ne dosjen e tenderit te EDT, ne kemi kërkuar edhe nje koment nga K RPP per këtë term dhe kemi marre përgjigje qe natyra e kontratës është natyra e njëjtë cle do te thotë se OE duhet te këtë pune te përfunduara ne furnizime ma autoambulanca ne 3 vitet e fundit ne vlere minimale prej 150.000,00 euro, (autoambulanca),prandaj ne kete pike ne mendojmë se AK Komuna e Prizrenit ka here prape lëshim gjate rivlerësimit te ofertave.

Pika 2 Ne jemi eliminuar nga AK Komuna e Prizrenit se norma e TVSH për ambulanca duhet te aplikohet 8% ne e bëjmë ne dijeni AK-Komuna e Prizrenit se ne jemi vet modifikues ambulancave ne nje investim te përbashkët me kompaninë Auto shtëpia SIQAN1, dhe e kemi per obligim qe ta aplikojmë normën e TVSH 18%, AK eshte thirrur ne ligjin mbi TVSH-ne ne te cilen norme 8% duhet ta aplikojnë Importet e autoambulancave, kurse ne nuk bejm importe te autoambulancave por bejm importe te automjeteve komerciale dhe ato modifikojmë ne Kosove ne autoambulance dhe per kete e kemi obligim qe ti paguajmë 18% normën e TVSH-se, po ashtu te bashkëlidhur kësaj kërkesë per rishqyrtim po ju dërgojmë edhe DUD doganor ne te cilat është aplikuar norma 18%, po ashtu pa ju dërgojmë edhe Fatura te cilat janë faturuar Institucioneve Publike me normën 18%, per me tepër te Web te Dogana e Kosovës është lista e produkteve me normën fikse 8%, prandaj eliminimi jone ne këtë pike nuk qëndron sepse ne rast te Importit te Autoambulancës është norme me e ulet dhe ne raste te Modifikimit te brendshëm aplikohet normë tjetër kështu qe ne këtë pike te eliminimit tone nuk qëndron sepse për te njëjtin produkte mund te aplikohen dy norma te TVSH por vetem ndryshon modifikimi ne Kosove dhe importimi nga jashtë Kosovës por nuk do te thate se njëra ose tjetra kane gabuar ne gabim aritmetik +1-2% sepse gabimet aritmetike konsiderohen ne mbledhjen dhe shumëzimin sasive dhe çmimit dhe 'Jo taksa e cila aplikohet, pasi qe ju keni kërkuar qe çmimi duhet te përfshijë gjitha taksat e aplikueshme ne Kosove dhe ne i kemi përfshirë gjitha taksat ne cenimin e kalkuluar.
Kompania jone keni kontrata per furnizime me autoambulanca edhe me zyren e BE-se ne rajon, te cilat janë ne implementim e sipër dhe disa te tjera edhe I kemi përfunduar, dëshmitë e te cilave kemi paraqitur edhe ne dokumentet e ngarkuara ne e-prokurimin për tenderin ne fjale.
Autoambulancat tona jane vlerësuar edhe nga eksperte te jashtëm dhe te brendshëm per cilësinë e tyre asistencën tone përgjatë gjithë kohës dhe garancionet e ofruara per pajisjet si dhe trajnimin e stafit mjekësor.

Po ashtu AK Komuna e Prizrenit ka rekomanduar për kontrate një kompani e cila ne te kaluarën nuk ka bere furnizime me asnjë (1) autoambulance, me çka është ne kundërshtim te plote me kërkesat e dosjes se tenderit sepse kërkesa kryesore e AK është qe OE duhet te dëshmoj se ka realizuar kontrata te natyrës se Kontratës-Autoambulanca ne vlere 150.000,00 Euro dhe ju ne vend qe ta eliminoni direkt nga gara këtë kompani e keni rekomanduar per kontrate per here te dyte edhe pas rivlerësimit te ofertave qe është plotësisht ne kundërshtim kërkesat e dosjes se tenderit dhe duke e shkelur ligjin e prokurimit, AK duhet ta këtë te qarte se ne këtë aktivitet te prokurimit nuk behet fjale për mjete motorike por behet nal per autoambulanca te cilat kane pajisje mjekësore dhe duke marr parasysh se furnizimi me Autoambulanca duhet te këtë një kujdes te veçante pa si qe nuk be het Oat vetëm për automjete por barra kryesore e nje ambulance janë pajisjet mjekësore te cilat duhet te jene ne përputhje me kërkesat e AK Komuna e Prizrenit kurse OE i rekomanduar për kontrate nuk ka arritur ta plotëson kushtin kryesore te kërkuar nga AK Komuna I e Prizrenit qe te dëshmon se ka realizuar kontrata te natyrës se

njëjtë pra furnizime me ambulanca.
Ne kemi pasur qasje ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, dhe atë e kemi here këtë kërkesë re email bashm..zogajtp.rksTgov,,pet dhe ate sipas kërkesës se datës 28/09/2020 me qka e kemi vërtetuar se OE nuk I plotëson kërkesat e dosjes se tenderit prandaj nuk qëndron pretendimi i AK i cili ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim ka than qe nuk kemi kërkuar qasje ne dokumente.
Prandaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtuesi Prokurimit qe ankesa Janë te aprovohet si e bazuar dhe ta anulon vendimin e AK për dhënie te kontratës, pasi qe kjo lende është për here te dyte ne OSHP dhe AK nuk ka bere prape vlerësim te saktë te ofertave kërkojmë qe te udhëzohet AK Komuna e Prizrenit qe per kontrate te shpërblehet kompania jone D & T Group sh.p.k sepse jemi kompania me e përgjegjshme me çmimin me te lire ne këtë aktivitet te prokurimit.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.
-OE "D&T Group " është si tenderues i i eliminuar nga AK si i pa përgjegjshëm per shkak se ka gabime matematikore ne listën e çmimeve mbi +- 2%.
- Po ashtu sipas AK, OA ankues ka llogaritë normën e TVSH-se ne vlere prej 18 %, ndërsa për autoambulanca dhe pajisje mjekësor sipas ligjit nr.05/L-037 per Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) kjo norme është ne vlere prej 8%.
- OE ankues pretendon se AK ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit për aftësitë teknike profesionale 9.1& 9.2 për kontrata te kryera te natyrës se ngjashme.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni i vlerësimit te ofertave rekomandon për kontrate OE "Profitech".

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
Ka pasur vendim te me hershem per këtë aktivitet te prokurimi me nr.794-796/20

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshëm).
Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "D&T Group"

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin te Pika 1 e kësaj ankese, se AK nuk ka bere vlerësim te saktë te ofertës sipas kërkesave te dosjes se tenderit, ka bere lëshim te madh duke e rekomanduar për kontrate kompaninë PROFITECH sh.p.k e cila nuk i plotëson as kërkesat minimale te kërkuara ne dosjen e tenderit sipas kërkesave te FDT, pasi qe në te kaluarën kompania PROFITECH sh,p.k nuk ka bere asnjë furnizim me autoambulanca sipas kërkesës se dosjes së tenderit te FDT sepse kërkesa e AK Komuna e Prizrenit ne dosjen e tenderit konkretisht te FDT pika 9.1 & 9.2 është shume e qarte-ku thuhet: OE duhet te këtë se paku 150.000,00 euro kontrata te realizuara gjate 3 viteve te fundit, te **natyrës së kontratës**, kompania ne fjalë nuk ka here asnjë furnizim te natyrës se kontratës Furnizimin me Ambulanca, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet te prokurimit ka bere Rivlerësimin e ofertave duke u bazuar ne vendimin e Panelit Shqyrtues te OSHP-se nr.794-796/20. Sipas këtij vendimi është kërkuar qe bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-se, AK te kërkoj informacion shtese lidhur me projektet e realizuar te natyrës se kontratës nga OE i rekomanduar për kontrate.

Komisioni i rivlerësimit te AK-se ka bere kërkesë për informacion shtese dhe me datën 01.12.2020 ka pranuar dokumentacionin shtese ne e-prokurim dhe ne e-mail zyrtar nga OE i rekomanduar për kontrate. Pas kontrollimit te dokumentacionit shtese te OE i rekomanduar për kontrate, komisioni vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate ka kontrata për furnizime me automjete, makineri, pajisje te ndryshme specialistike për Forcën e Sigurisë se Kosovës, ku për vitet 2018-2020 ka një qarkullim mbi 2 milion euro.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate e plotëson edhe kriterin e kërkuar me referenca për furnizime te natyrës se kontratës ne shumen mbi 150.000,00 €. Referencat e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate te cilat lidhen me furnizime me automjete, makineri e pajisje specialisitke për FSK sipas mendimit te ekspertit shqyrtues i përkasin te njëjtës natyre te kontratës për furnizim ne këtë aktivitet te prokurimit dhe si te tilla janë te pranueshme dhe e plotësojnë kërkesën e dosjes se tenderit. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues te Pika 2, se ne jemi eliminuar nga AK Komuna e Prizrenit për shkak se norma e TVSH për ambulanca duhet te aplikohet 8%, ne e bëjmë ne dijeni AK-në, se ne jemi **vet modifikues të ambulancave** ne një investim te përbashkët me kompaninë Auto shtëpia SIQAN1 dhe e kemi për obligim qe ta aplikojmë normën e TVSH 18%, AK është thirrur ne ligjin mbi TVSH-ne në të cilën norme **8% duhet ta aplikojnë importet e autoambulancave**, kurse ne **nuk bëjmë importe te autoambulancave por bëjmë importe te automjeteve komerciale dhe ato modifikojmë ne Kosove ne autoambulance** dhe për këtë e kemi obligim qe ti paguajmë 18% normën e TVSH-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Komisioni i rivlerësimit te AK-se, po ashtu duke u bazuar ne vendimin e panelit shqyrtues nr.794-796/20 lidhur me pikat kontestuese për normën e TVSH-se, 8% apo 18% është rekomanduar qe gjate rivlerësimit AK-ja të beje kalkulimin dhe vërtetoj saktë nëse ka gabime aritmetikore mbi 2% te vlerës totale te ofertës.
Mbi këtë baze AK ka analizuar dhe ka vlerësuar duke u bazuar ne nenin 26 pika 2.13 te ligjit nr.05/L-037 për TVSH, thuhet qe norma e reduktuar e TVSH-se llogaritet dhe paguhet prej **8%** për furnizime me **Autoambulancat**, pajisjet mjekësore etj. Kurse OE ankues normën e TVSH-se ne tabelën e përshkrimit te çmimeve e ka dhënë prej **18%**. Kjo vlere e TVSH është ne kundërshtim me ligjin e TVSH që ka të bëjë me importim, furnizim me autoambulanca. Po ashtu me këtë vlere te TVSH, oferta e OE ankuese me gabime aritmetikore tejkalon me shume se **± 2% vlerën totale te ofertës**.

Ky tejkalim është ne kundërshtim me piken 3 te nenit 59 te LPP-se dhe si te tille e bene ofertën e pa përgjegjshme. Pohimi i OE ankues se kompania e tyre **autoambulancën e vet modifikon** ne bashkëpunim me një kompani tjetër vendore, e rëndon edhe me tepër situatën, sepse AK nuk pranon modifikime por autoambulanca duhet te vije **origjinal nga prodhuesi**. Kështu është kërkuar edhe ne dosjen e tenderit qe katalogu për automjetin te jete nga prodhuesi e jo modifikim vendor.

Ne anën tjetër OE i rekomanduar për kontrate, ka ofruar autoambulancën e kompletuar nga **prodhuesi** me destinim përkatës **si produkt final**. Mbi këtë baze eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor të **pa bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka zbatuar vendimin e panelit shqyrtues nr.794-796/20 dhe ka bere rivlerësimin e ofertave. Ka eliminuar ofertën OE ankues si tenderues i pa përgjegjshëm për shkak se ka ofruar normën e TVSH ne listën e çmimeve ne vlere prej 18% qe është ne kundërshtim me ligjin e TVSH ne Kosove. Norma prej 18% e llogaritur nga OE ankues e tejkalon gabimin aritmetikore me shume se 2% te vlerës totale te ofertës e cila nuk lejohet me nenin 59 te LPP-se.
Është rekomanduar për kontrate OE i përgjegjshëm me çmim me te ulet. Gjatë procesit te ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në këtë aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se. Po ashtu është respektuar edhe neni 60 i LPP-se kriteri për dhënie te kontratës. Vlen te theksohet se oferta e rekomanduar për kontrate ka çmimin me te ulet për mbi 1300 € se oferta e OE ankues.. Nuk ka shkelje te neneve te LPP-se te përmendura ne ankesën e operatorit ekonomik ankues.

Nga ajo qe e sqaruam me lartë ne përgjigjet e pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të **refuzohet** si e pa bazuara.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **Vazhdoj** me dhënie te kontratës për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare në Komunën e Prizrenit**, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prizrenit.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "D&T Group".